

AKTI I THEMELIMIT

**I shoqerise tregtare me perjegjesi të kufizuar:
“ Nika 2007 ” Sh.p.k.**

NENI 1

Ne Sarande sot me daten 31.03.2022, shtetasi i poshteshenuar, me vullnet te lire dhe te plote krijone shoqerine me perjegjesi te kufizuar te emertuar:

“ Nika 2007 ” Sh.p.k.

NENI 2

Selia Qendrore e shoqerise: **“ Nika 2007 ” Sh.p.k.** do te jete ne adresën: Vlore, Sarande, Lagjja nr.3, Rruga Skenderbeu, Godina Nr.25, Kati i Pare.

NENI 3

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte pa afat te percaktuar, duke filluar afati nga dita e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim Q.K.B. per të bere shenimet e nevojshme.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare: **“ Nika 2007 ” Sh.p.k.** do te jete: Shitje dhe Blerje Pasuri te pa luajtshme, Sherbime ne fushen e turizmit.

NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100,000 leke (njeqindmije) leke, formuar dhe nenshkruar nga (nje) ortak ose 1 kuote .

- Ortaku themelues: Pandeli Nika, Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (njeqind mije) Lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaket kane pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge të ligjshme. Shoqeria per gjigjet vetem me kapitalin e saj.



NENI 6

Kapitali Themeltar i shoqerise mund të rritet ose zvogelohet, mbi bazen e vendimit me shkrim qe merr Asambleja e Ortakeve, i cili nenshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bere dhe shenimet ne regjistrin perkates. Ne keto raste, vendimi merret nga ortaket qe perfaqesojne 100% te kuotave te kapitalit themeltar.

NENI 7

Ortaket duhet te bejne perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise , te ruajne sekretin e saj dhe te mos te demtojne interesat e personave te tjere te shoqerise.

NENI 8

Shoqeria cel llogari bankare ne leke dhe ne cdo lloj valute te huaj, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shteterore, me qellim per të kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

NENI 9

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- 1-Asambleja e Ortakeve
- 2-Administratori

Kompetencat e Asamblese se Ortakeve dhe Administratorit do te percaktohen ne statutin e shoqerise tregtare “ **Nika 2007 ” Sh.p.k.**

NENI 10

Shoqeria do te drejtohet nga Administratori i saj Z. Pandeli Nika

NENI 11

Çdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne të kunderten kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesor Sarande.

NENI 12

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, vecanerisht me ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 ”Per Tregetaret dhe shoqerite tregetare” (te ndyshuar).

NENI 13

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.




NENI 14

Akti i Themelimit u perpilia ne 2 (dy) kopje dhe u nenshkrua rregullisht nga ortaku themelues.

Themeluesi i shoqerise

Pandeli Nika

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Nika".